



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 03.06.2025

Numër Protokolli: 3743/2025

A.nr.830/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.830/2025, të datës 06.05.2025, të parashtruar nga ankuesi Z.H, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.830/2025, e datë 06.05.2025, e parashtruar nga ankuesi Z.H.

A r s y e t i m

Ankuesi Z.H(*tutje referuar ankuesi*), më datë 05.05.2025, përmes emailit ankesa.kpmsbck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 06.05.2025 nën shenjën A.nr.830/2025, kundër Njoftimit të datës 29.04.2025 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për refuzimin e aplikacionit, lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN000117027 për pozitën “Drejtor i Përgjithshëm”, në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 14.03.2025, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN000117027, për pozitën “Drejtor i Përgjithshëm”, në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, me afat aplikimi nga data 15.03.2025 deri më datë 14.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës, ankuesit sipas Njoftimi të datës 29.04.2025 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme i është refuzuar aplikacioni pe arsyetimin se *nuk ka dorëzuar pasaportës/certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës por ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me afat të skaduar.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Njoftimit të datës 29.04.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për refuzimin e aplikacionit, pretendon se ka dorëzuar dokumentacionet e kërkuara sipas konkursit, dhe refuzimi i aplikacioni është bërë në mënyrë të pa drejtë ngase kjo është çështje teknike ku ka mundur të verifikohet nga NJMBNJ. Kërkon që ankesa të aprovohet dhe të obligohet institucionit përkatës të përfshirë në listë për të vazhduar tutje me procedurat.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht nenit 47 paragrafi 10 i cili përcakton se: *“10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 06.05.2025, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtror ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankuesit të datës 06.05.2025, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017027, rrjedhë se ankesa e ankuesit A.nr.830/2025, e datës 06.05.2025, është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 47 paragrafi 10 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.830/2025, nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.830/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Z.H;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.